



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË SHTETASVE TË CILËT MUND TË EMËROHEN KRYESISHT ANËTARË TË KQV-VE PËR ZGJEDHJET PËR NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 29.06.2019, me pjesëmarrjen e:

| | | |
|---------|-----------|------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për miratim të listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe propozimet e depozituara,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", ka publikuar në gazeta dhe faqen e internetit njoftimin për shprehje interesi nga shtetas që janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit të KQV-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Pas miratimit nga KQZ të listave emërore të shtetasve që mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV në 61 Bashkitë, kanë paraqitur kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Shkodër, kanë shprehur interes edhe 68 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Malësi e Madhe, kanë shprehur interes edhe 9 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.



Nr. 928 i Vendimit

Data 29.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Berat, kanë shprehur interes edhe 9 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Bulqizë, kanë shprehur interes edhe 5 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Dibër, kanë shprehur interes edhe 7 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Elbasan, kanë shprehur interes edhe 4 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Fier kanë shprehur interes edhe 3 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Kamëz kanë shprehur interes edhe 4 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Klos kanë shprehur interes edhe 7 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Korçë kanë shprehur interes edhe 12 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Krujë kanë shprehur interes edhe 4 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Kukës kanë shprehur interes edhe 7 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Lushnje kanë shprehur interes edhe 6 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Mirditë kanë shprehur interes edhe 5 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Pogradec kanë shprehur interes edhe 2 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Pukë kanë shprehur interes edhe 2 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Selenicë kanë shprehur interes edhe 7 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Tiranë kanë shprehur interes edhe 30 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Vlorë kanë shprehur interes edhe 12 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Cërrik kanë shprehur interes edhe 7 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Gjirokastrë kanë shprehur interes edhe 5 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Këlcyrë kanë shprehur interes edhe 7 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Kurbin kanë shprehur interes edhe 7 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Mallakaster kanë shprehur interes edhe 7 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Sarandë kanë shprehur interes edhe 9 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.



Nr. 928 i Vendimit

Data 29.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Shijak kanë shprehur interes edhe 10 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Tepelenë kanë shprehur interes edhe 8 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Tropojë kanë shprehur interes edhe 10 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Për Zonën Zgjedhore të Bashkisë Kavajë kanë shprehur interes edhe 5 shtetas për të qënë anëtar të QV-ve.

Pas verifikimit të DPB dhe shyrimit të dokumentacionit të paraqitur rezulton se shtetasit përmbushin kushtet ligjore për tu emëruar kryesisht në detyrën e anëtarit të KQV-së, si dhe nuk janë në kushtet e papajtueshmërisë për ushtrimin e kësaj detyre:

- janë zgjedhës;
- kryesisht janë me arsim të mesëm;
- janë me vendbanim në zona zgjedhore përkatëse (Bashkitë përkatëse);
- janë të padënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- nuk janë marrë masa disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur verifikimit të të dhënave dhe verifikimit të gjendjes gjyqësore, rezulton se shtetasit që kanë shprehur interes për tu emëruar kryesisht anëtarë të KQV në tetë zonat zgjedhore si më sipër listuar, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 dhe 38 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, në zonat zgjedhore:

- Bashkia Shkodër sipas lidhjes 1;
- Bashkia Malësi e Madhe, sipas lidhjes 2;
- Bashkia Berat, sipas lidhjes 3;
- Bashkia Bulqizë, sipas lidhjes 4;
- Bashkia Dibër, sipas lidhjes 5;
- Bashkia Elbasan, sipas lidhjes 6;
- Bashkia Fier, sipas lidhjes 7;
- Bashkia Kamëz, sipas lidhjes 8;
- Bashkia Klos, sipas lidhjes 9;
- Bashkia Korçë, sipas lidhjes 10;
- Bashkia Krujë, sipas lidhjes 11;
- Bashkia Kukës, sipas lidhjes 12;
- Bashkia Lushnje, sipas lidhjes 13;
- Bashkia Mirditë, sipas lidhjes 14;
- Bashkia Pogradec, sipas lidhjes 15;
- Bashkia Pukë, sipas lidhjes 16;
- Bashkia Selenicë, sipas lidhjes 17;



Nr. 928 i Vendimit

Data 29.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

- Bashkia Tiranë, sipas lidhjes 18;
 - Bashkia Vlorë, sipas lidhjes 19;
 - Bashkia Cërrik, sipas lidhjes 20;
 - Bashkia Gjirokastër, sipas lidhjes 21;
 - Bashkia Këlcyrë, sipas lidhjes 22;
 - Bashkia Kurbin, sipas lidhjes 23;
 - Bashkia Mallakastër, sipas lidhjes 24;
 - Bashkia Sarandë, sipas lidhjes 25;
 - Bashkia Shijak, sipas lidhjes 26;
 - Bashkia Tepelenë, sipas lidhjes 27;
 - Bashkia Tropojë, sipas lidhjes 28;
 - Bashkia Kavajë, sipas lidhjes 29;
2. KZAZ që administrojnë procesin në zonat zgjedhore të renditura në pikën 1, të emërojnë kryesisht anëtarë të KQV-ve deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje, duke përzgjedhur shtetas nga lista e miratuar sipas procedurave të Udhëzimit të KQZ nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

| | | |
|----------------|------------------|-------------------|
| Klement | ZGURI - | Kryetar |
| Denar | BIBA - | Zv/Kryetar |
| Bledar | SKËNDERI- | Anëtar |
| Edlira | JORGAQI- | Anëtare |
| Rezarta | BITRI- | Anëtare |



Nr. 928 i Vendimit Data 29.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019